

GJYKATA E APELIT

Lënda: AC.nr. 3905/2012

Date: 12 mars 2013

GJYKATA E APELIT në shkallë të dytë përmes Kolegjit të përberë prej Gjyqtarës Civile të EULEX-it ROSITZA BUZOVA, si Kryetare e Kolegjit, Gjyqtari kosovar MUHARREM SHALA dhe Gjyqtari kosovar NENAD LAZIĆ, si anëtarë të Kolegjit;

Në lëndën civile të paditësit MB nga fshati Sllovi, Komuna e LIPJANIT, me përfaqësuesin e autorizuar Avokatin EA kundër të paditurës “KT” - LIPJAN me pjesëmarrje të palës së tretë në anën e të paditurës DZ, me herët nga fshati Muzeqinë, Komuna e Shtimes, tani me vendbanim ne Batoqina, Republika e Serbisë, për anulim te vendimit mbi ndarjen e banesës në shfrytëzim;

Pas pranimit të ankesës së Avokatit EA të parashtruar në emër të MB kundër aktvendimit C.nr.122/2007 të Gjykatës Komunale në LIPJAN, të datës 25 prill 2012;

Pas këshillimit dhe votimit në seancën e Kolegjit të mbajtur në pajtim me Nenin 190, paragrafi 1, hipoteza e dytë në lidhje me Nenin 208 të Ligjit Nr. 03/L-006 mbi Procedurën Kontestimore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 38/2008), e ndryshuar dhe e plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-118 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/12) (tash e tutje “LPK”) me 12 mars 2013;

Me anë të kësaj sipas Nenit 142, paragrafi 5, Neni 18, paragrafi 1 dhe Neni 23, paragrafi 1 i LPK lëshon si në vijim

A K T V E N D I M

GJYKATA E APELIT SHPALLET si JOKOMPETENTE për të vendosur ankesën e parashtruar ne emër të MB nga fshati Sllovi, Komuna e LIPJANIT nga përfaqësuesi i tij i autorizuar Avokati EA nga PRISHTINA kundër aktvendimit C.nr.122/2007 te Gjykatës Komunale të LIPJANIT, të datës 25 prill 2012.

Lënda i REFEROHET DHOMËS SË POSAÇME TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS MBI ÇËSHTJET E NDËRLIDHURA ME AGJENCINË E PRIVATIZIMIT, si gjykatë kompetente për të vendosur këtë ankesë në shkallë të dytë.

ARSYETIM

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Me aktvendimin C.nr.122/2007 të Gjykatës Komunale në LIPJAN, të datës 25 prill 2012 ajo “e shpalli vetën si jo kompetente në çështjen lëndore për të gjykuar lëndën dhe për të vendosur pasi që aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm të dërgoj atë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës si gjykatë me kompetencë lëndore të çështjes.” Në arsyetim Neni 4 i Ligjit Nr. 04/L-033 mbi Dhomën e

Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës mbi Çështjet e Ndërlidhura me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/11) i referohet sikurse duke i ofruar “kompetencë ekskluzive të Dhomës së Posaçme në të gjitha lëndët dhe procedurën me ndërmarrjet me pronësi shoqërore dhe korporata dhe në veçanti në lidhje me kërkesat paditë pronësore kundër një ndërmarrje të tillë apo korporatë që pretendohet të jetë ngritur gjatë apo para kohës që ajo ka qenë çështje e autoritetit administrativ të AKM-së apo Agjencisë.” Duke e kualifikuar padinë në lëndë nën këtë normë si e parashtruar kundër ndërmarrjes me pronësi shoqërore të administruar nga AKP, Gjykata Komunale në LIPJAN sipas Nenit 392, paragrafi 1, pika b) LPK vendosi të deklaroj pa jurisdikcion thelbësor në këtë lëndë dhe të referoj atë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.

2. Më 11 maj 2012, Avokati EA si përfaqësues i autorizuar i paditësit MB parashtroi në emër të tij një ankesë në Gjykatën e Qarkut në PRISHTINË përmes Gjykatës Komunale në LIPJAN kundër aktvendimit të saj C.nr.122/07, të datës 25 prill 2012. Bazimi kërkoi që kundërshtimi i saj është shkelje thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore sipas Nenit 182, paragrafi 1 në lidhje me Nenin 392, paragrafi 1, pika b) e LPK, duke pasur ndikim në të drejtën dhe ligjshmërinë e aktvendimit. Sipas mendimit të ankuesit Neni 4 i Ligjit Nr. 04/L-033 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës ishte aplikuar gabimisht sa i përket “banesës së kontestueshme, kishte një procedurë pranë Drejtoratit për Çështje Pronësore dhe Banesore, ku me vendimin e saj të plotfuqishëm urdhëroi palët të vazhdojnë atë në gjykatën vendore”. NSH “KT” - LIPJAN, tani në likuidim, më herët nuk është legjitimuar të jetë e paditur më në lëndë që nuk ka të drejta pronësore mbi banesën, me pronësi të DZ, dhe në posedim të MBT. Kërkohet nga shkalla e dytë të anulohet aktvendimin e ankimuar dhe të kthej lëndën në gjykatë të njëjtë të shkallës së parë për rigjykim.

3. Nuk janë parashtruar përgjigje në ankesë në pajtim me Nenin 187, paragrafi 1 i LPK. Taksa gjyqësore që duhet për atë ishte kërkuar nga aktvendimi C.nr.122/2007 i Gjykatës Komunale të LIPJANIT, të datës 25 prill 2012 sipas Nenit 387, paragrafi 1, pika m) e LPK, Neni 253, paragrafi 5 i LPK dhe Neni 10 i Udhëzimit Administrativ № 2008/2002 i Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore. Shuma e saj ishte paguar nga MB me transfer bankar më 11 maj 2012.

4. Më 14 shtator 2012, ankesa dhe lënda janë dërguar në Gjykatën e Qarkut në PRISHTINË dhe janë regjistruar atje nën numrin e dosjes AC.nr.989/12.

5. Lënda civile ishte zgjedhur bazuar në Nenin 5, paragrafi 1, pika c), nën pikat (ii) dhe (iii) të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndës dhe Caktimin e Lëndës të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (“Ligji Nr 03/L-053 mbi Kompetencat”) (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 27/2008) dhe Neni 3, paragrafi 1 i Udhëzimeve mbi Përzgjedhjen e Lëndës dhe Caktimin e Lëndës për Gjyqtarët e EULEX-it në Lëndët Civile (“Udhëzimet”) me aktvendimin ref.nr.ED/EJU/MJU/0011/cd/12, të lëshuar më 1 nëntor 2012 nga Gjyqtari i EULEX-

it, duke vepruar si i deleguar i Kryetarit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it sa i përket vendimit ref.nr.2012.OPEJ.0063-0001, të datës 30 tetor 2012. Pas procedurës së marrjes sipas Nenit 5, paragrafi 7, fjalia e parë e Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat dhe Neni 3, paragrafi 6 i Udhëzimeve janë kryer me aktvendimin ref.nr.2012.OPEJ.0145-0001 të lëshuar nga zëvendës Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it më 26 dhjetor 2012 sipas Nenit 5, paragrafi 7, fjalia e dytë e Ligjit Nr 03/L-053 mbi Kompetencat dhe Neni 3, paragrafi 8 i Udhëzimeve, lënda iu është caktuar një kolegji të përzier sipas Nenit 5, paragrafi 2, fjalia e parë e Ligjit Nr 03/L-053 mbi Kompetencat me shumicën e Gjyqtarëve kosovar sipas Nenit të saj 5, paragrafi 5.

6. AC.nr.989/12 i Gjykatës së Qarkut në PRISHTINË si jo e përfunduar më 31 dhjetor 2012 sipas dispozitës kalimtare të Nenit 39, paragrafi 1 i Ligjit Nr 03/L-199 mbi Gjykatat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 49/11) më 1 janar 2013 është bërë *ex lege* një lëndë në Gjykatë të Apelit. Prandaj, Kryetares së Kolegjit të EULEX-it i ishte caktuar në procedurë ankimore me vendimin të Kryetarit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it ref.nr.2103.OPEJ.0043/002, të datës 28 janar 2013, ndërsa Gjyqtarët Kosovarë – anëtarët e kolegjit ishin caktuar me vendimin AGJ.I.nr.16/2013 të Kryetarit të Gjykatës së Apelit, të datës 31 janar 2013. AC.nr.989/12 të Gjykatës së Qarkut në PRISHTINË ishte regjistruar sërish nën numrin e dosjes së re – AC.nr.3905/12 të Gjykatës së Apelit.

II. PËRMBLEDHJE E PROCEDURËS SË SHKALLËS SË PARË

7. Më 5 mars 1993, MB si paditës parashtroi padi kundër Ndërmarrjes me Pronësi Shoqërore (NSH) “KT” - LIPJAN dhe DZ, si të paditur. Paditësi pretendoi që me Vendim Nr 012-349 të NSH “KT”-LIPJAN, të datës 29 maj 1990 atij iu ishte dhënë banesa prej 45 m² në LIPJAN, Rr.“Vuk Karadzic”. P+4, L-2, nr.V/17, dhe kanë jetuar në mënyrë të pandërprerë deri në parashtrim të padisë. Pas shkarkimit jo ligjor punës së tij, NSH “KT” i ka ndarë banesën DZ në shkelje të rregullave dhe procedurës, të vëna nga rregullorja e kësaj ndërmarrje mbi dhënien e banesës për shfrytëzim. Petitumi është gjykata të anuloj vendimin si të paligjshëm. Padia me përmbajtjen fillestare ishte regjistruar si C.nr.104/1993 të Gjykatës Komunale në LIPJAN.

8. Me aktvendimin C.nr.104/93 të Gjykatës Komunale në LIPJAN, të datës 25 qershor 2006 padia ishte shpallur e tërhequr në lidhje me DZ *si i paditur* dhe pjesëmarrja e tij në lëndë ishte lejuar si *palë e tretë* në anën e të paditurës NSH “KT”-LIPJAN.

9. Me aktvendimin C.nr.104/1993 të Gjykatës Komunale në LIPJAN, të datës 18 mars 1998 lënda ishte ndërprerë për dështim të paditësit, pas thirrjes së tij në mënyrë të rregullt, për t’u paraqitur në seancë në atë datë dhe propozimi i të paditurit për ndërprerje sipas Nenit 216, paragrafi 1 i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (Gazeta Zyrtare e RSFJ Nr. 4/77, 36/80, 69/82, 58/84, 74/87, 57/89, 20/90, 27/90, 35/91 dhe Gazeta Zyrtare e RSFJ Nr. 27/92, 31/93, 24/94, dhe 12/98) (LPK 1977).

10. Më 16 qershor 1998, Avokati EA, autorizoi përfaqësuesin e paditësit, parashtroi parashtresë për vazhdim të procedurës së ndërprerë bazuar në Nenin 217, paragrafi 2 i LPK 1977. Kërkesa mbeti e pavendosur. Ishte përsëritur nga parashtresat e paditësit të datës 28 maj 2003 dhe 2 prill 2007 derisa lënda ishte ri-aktivizuar nga parashtresat e paditësit të datës 28 maj 2003 dhe 2 prill 2007 derisa lënda ishte ri aktivizuar nga Gjykata Komunale në LIPJAN më 3 prill 2007 me numër të ri të dosjes – C.nr.122/2007.

11. Më 19 shkurt 2010 AKP parashtroi parashtresë që me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 03/L-067 të gjitha ndërmarrjet me pronësi shoqërore dhe asetet e tyre janë vendosur nën administrim të saj dhe kanë kërkuar informata sipas NSH “KT”LIPJAN (me të gjithë emrat e saj të mëhershëm të treguar), *inter alia* lista e lëndëve me pjesëmarrje të saj. Në përgjigje Gjykata Komunale në LIPJAN informoi AKP më 10 mars 2010 rreth lëndës C.nr.122/2007 dhe ofroi dosjen e saj të lëndës.

12. Më 5 shtator 2011, Ministria e Drejtësisë kërkoi përjashtimin e Gjyqtarit Kosovar të caktuar në lëndë pas marrjes së serishme të punës së saj prej 4 viteve të mosveprimit të saj. Me aktvendimin e Kryetarit të Gjykatës Komunale në LIPJAN të datës 7 tetor 2011 sipas nenit 70, paragrafi 1 i LPK ky përjashtim ishte lejuar, lënda ishte caktuar sërish dhe ishte propozuar marrja e saj nga EULEX-i.

13. Më 25 prill 2012, aktvendimi i ankimuar për jo kompetencë ishte nxjerrë nga Gjykata Komunale në LIPJAN në lidhje me padinë, e cila pas 19 viteve të vendosjes në procedurë të shkallës së parë përmbodhi të mësipërmen, mbeti e dështuar nga MB si paditës kundër NSH “KT”-LIPJAN si e paditur për anulim të Vendimit nr.554-01-012 të NSH “KT”-PRISHTINË, NKP - LIPJAN, të datës 11 mars 1992 për ndarje në shfrytëzim të banesës një dhomëshe me sipërfaqe prej 45 m² në LIPJAN, Rr.“Vuk Karadzic” P+4, L-2, nr.V/17 DZ-s, duke marrë pjesë si palë e tretë në lëndë.

III. KONSTATIMET SA I PËRKET KOMPETENCËS SË SHKALLËS SË DYTË NË ANKESË

14. Me qëllim të ekzaminimit të pranueshmërisë së ankesës kundër aktvendimit C.nr.122/2007 të Gjykatës Komunale në LIPJAN, të datës 25 prill 2012, dhe të vendos atë sipas meritës, Gjykata e Apelit duhet të ketë kompetencën e shkallës së dytë në këtë lëndë. Prandaj, sipas Nenit 17, paragrafi 1 në lidhje me Nenin 208 të LPK, trupi gjykues së pari duhet të ketë parasysh nëse kjo ankesë bie apo nuk bie brenda juridiksionit të Gjykatës së Apelit nën Ligjin e aplikueshëm. Sipas Nenit 18, paragrafi 1 në lidhje me Nenin 208 të LPK ky përcaktim është lejueshëm *ex officio*, edhe pa kundërshtime të palëve, gjatë tërë procesit të procedurës, pa ndonjë afat ndalues në këtë çështje. Këto dispozita, duke qenë të formuluar në mënyrë të përgjithshme dhe në mënyrë sistematike të vendosura në Kapitullin II, Neni 1 i LPK si i përbashkët për të gjitha llojet e juridiksionit, aplikohen për kompetencë të shkallës së dytë funksionale gjithashtu. Kështu është e garantuar që gjykata në procedurë

kontestimore gjithnjë do të veproj brenda kufinjëve të juridiksionit të saj siç është paraparë nga ligji sipas nenit 29 të LPK, pa shkelje.

Ligji Nr 04/L-033 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës mbi Privatizimin dhe Çështjet e Ndërlidhura me Agjencinë e Privatizimit.

15. Bazuar në deklaratën e padisë e parashtruar fillimisht dhe së fundi e precizuar dhe faktet e verifikuara nga dokumentet e dosjes së lëndës në pajtim me Nenin 17, paragrafi 2 i LPK, Gjykata e Apelit e konsideron vetën si jo kompetente për të vendosur ankesën në këtë lëndë pasi që ajo bie nën juridiksionin ekskluziv të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës mbi Çështjet e Ndërlidhura të Agjencisë së Privatizimit (DHPGJS).

16. Gjykata Komunale në LIPJAN lëshoi aktvendim të kundërshtueshëm të shkallës së parë në C.nr.122/2007 (më herët C.nr.104/1993) më 25 prill 2012, ndërsa ankesa e MBT kundër saj ishte parashtruar më 11 maj 2012. Në këto rrethana Ligji Nr. 04/L-033 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës mbi Çështjet të Ndërlidhura me Agjencinë e Privatizimit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/11) (tash e tutje "LDHPGJS") është ajo që është në tërësi e aplikueshme. Në vend të parë, sipas Nenit të saj 15, LDHPGJS ka hyrë në fuqi më 1 janar 2012, para lëshimit të aktvendimit të kundërshtueshëm më 25 prill 2012 dhe inicimin e procedurës ankimore kundër saj më 11 maj 2012. Kështu që, kjo lëndë e shkallës së dytë në tërësi bie brenda kufinjëve të përkohshëm të LDHPGJS. Në vend të dytë, Neni 14, paragrafi 1 i LDHPGJS shfuqizoi dhe e zëvendësoi Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2002/13 mbi Themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës mbi Çështjet e Ndërlidhura me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, ndryshimet e saj, dhe tërë legjislacionin dytësor të lëshuar sipas kësaj. Prandaj, prej 1 janarit 2012 nuk ka mundur të i jepet më tej forcë apo efekt në parim, dhe në këtë lëndë konkrete civile. Kjo e dyta nuk do të finalizohet në pajtim me dispozitat procedurale të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/13 dhe legjislacioni dytësor i nxjerrë sipas kësaj bazuar në përjashtimin e Nenit 14, paragrafi 1 i LDHPGJS që i rezervon ato vetëm për lëndët në pritje më 1 janar 2012 para DHPGJS dhe në shkallë të avancuar procedurale. Në vend të tretë, dispozitat e LDHPGJS sipas Nenit të saj 14, paragrafi 2 mbizotëron pas mospërputhjes ndaj ndonjë akti tjetër ligjvënës. Përveç kësaj, Neni 1, paragrafi 1, nën paragrafi 1 i LPK përcakton qartë që juridiksioni dhe kompetencat e DHPGJS pas 1 janarit 2012 janë caktuar dhe ofruar LDHPGJS. Prandaj *per argumentum ad contrario*, ato nuk kanë mundur të udhëhiqen nga ndonjë ligj tjetër. Duke qenë ekskluzivisht të lejuara në Dhomën e Posaçme nga LDHPGJS këto funksione në fushëveprimin e tyre kufizojnë ato analoge të gjykatave të rregullta dhe kështu në hipoteza ndër-juridiksionale gjithnjë duhetë mbi peshojnë.

17. Dhoma e Posaçme ka kompetencë ekskluzive mbi të gjitha lëndët dhe procedurat që janë në mënyrë qartë të renditura në Nenin 4, paragrafi 1, nën paragrafët 1-12 të LDHPGJS, dhe në çështje të tilla të tjera të cilat mund t'i caktohen

asaj me ligj bazuar në delegimin e Nenit 4, paragrafi 1, nën paragrafi 11 i LDHPGJS në mënyrë të qartë parasheh kompetencën e DHPGJS të rishikoj dhe vendos ligjshmërinë e çdo aktgjykimi apo vendimi të lëshuar nga ndonjë gjykatë tjetër të Kosovës që përfshin apo në lidhje me ndonjë padi apo çështje të specifikuar në paragrafin 1. Kjo lëndë civile e shkallës së dytë plotëson të gjitha këto kritere dhe së këndejmi bie brenda kompetencës ekskluzive të DHPGJS sipas Nenit 4, paragrafi 1, nënparagrafi 11 i LDHPGJS. Në vend të parë, ankesa e MB kundër aktvendimit C.nr.122/07 të Gjykatës Komunale në LIPJAN, të datës 25 prill 2012 është kërkesë – mjet juridik për të shqyrtuar dhe vendosur në baza sipas Nenit 181, paragrafi 1, pika a) në lidhje me Nenin 208 të LPK ligjshmëria e vendimit në kuptim të Nenit 2, paragrafi 1, nënparagrafi 5 i LDHPGJS, ndryshe nga aktgjykimi, i nxjerrë në formë të aktvendimit sipas Nenit 142, paragrafi 2 in fine të LPK nga gjykata, tjetër nga DHPGJS. Në vend të dytë, vendimi i kundërshtuar për ligjshmërinë e saj në lidhje me padinë kundër NSH “KT” - LIPJAN, duke pasur statusin e ndërmarrjes me pronësi shoqërore sipas Nenit 2, paragrafi 1, nën paragrafi 6 i LDHPGJS për kontest gjoja të ngritur si datë e fillimit të procedurës në lëndën C.nr.104/1993 të Gjykatës Komunale në LIPJAN – 5 mars 1993. Ky moment i paraprinë datës – 13 qershor 2002, kur Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2002/12 mbi Themelimin e Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit, të ndryshuar nga Rregullorja e UNMIK-ut Nr.2005/18, e hyrë në fuqi dhe NSH “KT” - LIPJAN fitoi statusin e ndërmarrjes me pronësi shoqërore nën autoritetin administrativ të AKM-së sipas Nenit të saj 5.1, pika (a), nën pika (I). Në bazë të alternativës të dhënë në definicionin e “ndërmarrjes me pronësi shoqërore” nën Nenin 3 të Rregullores së UNMIK-ut Nr 2002/12 është jo me rëndësi nëse NSH “KT” ishte bazuar në Nenin 2, paragrafët 1, 2 apo 3 të Ligjit mbi Ndërmarrjet (Gazeta Zyrtare e RSFJ № 77/1988 me ndryshime në № 40/89, № 46/90 dhe № 61/90), Ligji i Punës së Bashkuar (Gazeta Zyrtare e RSFJ № 53/76 me ndryshime në № 57/83, dhe № 85/87) apo ligj tjetër i aplikueshëm, pasi që nuk ka transformim në domethënien e Nenit 3 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/12 duke ndikuar në statusin e saj, shumica e aseteve të saj me pronësi shoqërore dhe/apo kapital ndërmjet 22 marsit 1989 dhe 13 qershorit 2002. Përveç kësaj, kjo ndërmarrje kishte kontrollin e menaxhmentit të saj aktual në LIPJAN më 13 qershor 2002 dhe ishte duke operuar në Kosovë në pajtim me Nenin 5.2 (a) të Rregullores së UNMIK-ut Nr 2002/12, si dhe e regjistruar në Kosovë më 31 dhjetor 1988 në pajtim me Nenin 5.1, pika (a), nën pika (i) e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/12. Shumë me rëndësi këtu është që prej 13 qershorit 2002 NSH “KT” - LIPJAN, është regjistruar si ndërmarrje me pronësi shoqërore në Kosovë më 31 dhjetor 1988, ishte vendosur nën autoritetin administrativ të AKM-së sipas Nenit 5.1 dhe Nenit 6 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/12 deri më 1 korrik 2008 kur Ligji Nr. 03/L-067 mbi AKP (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 30/08) (“Ligji Nr. 03/L-067) ka hyrë në fuqi – Neni 32 i Ligjit Nr. 03/L-067, Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2002/12, siç është ndryshuar, ka përfunduar të ketë efektin e saj ligjor – Neni 31, paragrafi 2 i Ligjit Nr. 03/L-067, dhe AKP ishte themeluar si organ i pavarur publik – pasardhës i aseteve dhe përgjegjësive të AKM-

së–Neni 1 i Ligjit Nr.03/L-067, si dhe të *funksioneve për të administruar* në pajtim me Nenin 5, paragrafi 1 (a) (i) i Ligjit Nr. 03/L-067 *ndërmarrjet me pronësi shoqërore*. Sa i përket NSH “KT” - LIPJAN, kjo administratë prej 1 korrikut 2008 është verifikuar nga vërejtja e parashtruar nga AKP në gjykatë më 19 shkurt 2010 në pajtim me Nenin 29, paragrafi 3 i Ligjit Nr 03/L-067. Kjo administratë ishte bartur në AKP dhe ishte ushtruar nga AKP deri më 30 korrik 2012 kur ishte bartur në Komunën e LIPJANIT, pasi që kjo ndërmarrje ishte transformuar nga Ligji Nr.04/L-111 nga pronësia shoqërore në atë me pronësi publike (shih paragrafin 25 më poshtë). Duke përmbledhur, padia në C.nr.122/07 (më herët C.nr.104/93) parashtrohet kundër NSH “KT”-LIPJAN për kontestin që gjoja është ngritur prej datës së parashtrësës së saj më së voni – 5 mars 1993, para kohës kur kjo ndërmarrje ishte lëndë e autoritetit administrativ të AKM-së (13 qershor 2002 – 30 qershor 2008), dhe më vonë të AKP-së (1 korrik 2008 – 30 korrik 2012). Prandaj, padia *prima facie* kualifikoi brenda kufinjëve të këtij shqyrtimi ankimor plotëson Nenin 4, paragrafi 1, nën paragrafi 4 i LDHPGJS në bazë të *fushëveprimit subjektiv*, që do të thotë, legjitimitetin pasiv të paditurit dhe statusin e saj të kaluar ligjor të ndërmarrjes me pronësi shoqërore nën administrimin e AKM-së dhe pastaj të AKP-së në periudhën prej 13 qershor 2002 – 30 korrik 2012. Në vend të tretë, padia gjithashtu *prima facie* përputhet me Nenin 4, paragrafi 1, nën-paragrafi 5.1 të LDHVK në bazë të *çështjes së saj lëndore* duke pretenduar të drejtën e banimit të MB në banesën e kontestuar bazuar në Vendimin № 012-345 të Këshillit të Punëtorëve të NSH “KT”, të datës 29 maj 1990 dhe gjithashtu *interesimin* për të anuluar Vendimin Nr 554-01-012, të datës 11 mars 1992 për ndarje të saj DZ për shfrytëzim të saj. Banesa e kontestueshme si një *aset që gjindet në territorin e Kosovës me pronësi shoqërore më 22 mars 1989 nga data 13 qershor 2002* ishte vendosur në autoritet të AKM-së sipas Nenit 5.1 (a) (ii) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/12, e ndryshuar nga Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/18, deri më 1 korrik 2008 kur autoriteti i njëjtë ishte bartur në AKP në pajtim me Nenin 5, paragrafi 1 (a) (ii) i Ligjit Nr. 03/L-067. *Administrimi mbi asetet* siç është treguar qartë në Nenin e cituar 5.1 (a) (ii) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/12, e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2005/18, dhe Nenin 5, paragrafi 1 (a) (ii) i Ligjit Nr. 03/L-067 ishte vërtetuar pa marrë parasysh nëse ata kanë qenë të organizuar në entitet apo jo, bazuar në pronën me pronësi shoqërore në ato prej datës 22 mars 1989, përveç *administrimit të ndërmarrjeve* nga AKM në pajtim me Nenin 5.1 (a) (i) të Rregullores së UNMIK-ut Nr 2002/12, e ndryshuar nga Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/18, dhe nga AKP në pajtim me Nenin 5, paragrafi 1 (a) (i) i Ligjit Nr 03/L-067. E vlerësuar në atë aspekt, padia në C.nr.122/2007 e kualifikon sipas Nenit 4, paragrafi 1, nën paragrafi 5.1 i LDHPGJS duke pretenduar të drejtën dhe interesin në lidhje me banesën në fjalë *si një aset – pronë e patundshme e banimit mbi të cilën AKM dhe pastaj AKP ka vërtetuar autoritetin administrativ*. Në fund, padia duhet të përfshihet sipas Nenit 4, paragrafi 1, nën paragrafi 4 i LGJSK pasi që aseti i njëjtë ishte në *posedim* të NSH “KT”-LIPJAN, dhe të drejtat e kërkuara dhe intereset në lidhje me atë gjoja janë ngritur në periudhën prej 29 majit 1990 – 5 mars 1993 para

kohës kur kjo ndërmarrje ishte lëndë e autoritetit administrativ të AKM-së dhe pastaj të AKP-së (13 qershor 2002 – 30 korrik 2012). Duke e shqyrtuar me kujdes të gjitha dispozitat, trupi gjykues aktual arrin në përfundim që DHPGJS ka kompetencën ekskluzive të rishikoj dhe vendos ankesën e MBT kundër aktvendimit C.nr.122/2007 të Gjykatës Komunale në LIPJAN, të datës 25 prill 2012 në pajtim me Nenin 4, paragrafi 1, nënparagrafi 11 lexo në lidhje me Nenin 4, paragrafi 4 dhe Neni 4, paragrafi 1, nënparagrafët 5.1 dhe 5.4 të LDHPGJS.

18. Pasi që aktvendimi i kundërshtuar është për mos kompetencë të Gjykatës Komunale në LIPJAN, dhe referimi i lëndës në DHPGJS sipas Nenit 392, paragrafi 1, pika b) e LPK, e aplikueshme këtu është gjithashtu Neni 4, paragrafi 6, fjalia e dytë e LDHPGJS që në mënyrë të qartë tregon që *DHPGJS ka autoritetin ekskluziv për të përcaktuar nëse çështja specifike bie në fushëveprim të Nenit 4 apo jo, paragrafi 1 i LDHPGJS*. Rregulla është imperative dhe në përgjithësi e formuluar për përcaktim të ekzistimit apo mos ekzistimit të juridiksionit në të gjitha lëndët dhe procedurat e paraqitura në Nenin 4, paragrafi 1 i LDHPGJS, *pa marrë parasysh në nivelin e shkallës së tyre të parë apo të dytë*. E lexuar në mënyrë negative, Neni 4, paragrafi 6, fjalia e dytë e LDHPGJS e bën të palejueshme një përcaktim të tillë nga ndonjë gjykatë tjetër që pa marrë parasysh nga rangu i saj në mënyrë valide nuk mund të vendos nëse lënda është brenda apo jashtë juridiksionit të DHPGJS, siç është paraparë nga Neni 4, paragrafi 1 i LDHPGJS. Kjo është shprehje e ekskluzivitetit dhe garancës sa i përket asaj në DHPGJS është bartur në Nenin 4, paragrafi 6, fjalia e dytë e LDHPGJS, fuqia rastësisht apo si çështje e principit në procedurë të administroj në kompetencë apo jo kompetencë të saj.

19. Përderisa Neni 4, paragrafi 1 i LDHPGJS i paraqet paditë, çështjet, lëndët dhe procedurën në juridiksion të DHPGJS, *kështu në mënyrë pozitive duke e cekur atë*, Neni 4, paragrafi 5, fjalia e parë e LDHPGJS *në mënyrë negative e paraqet atë duke përjashtuar saktësisht paditë, çështjet, lëndët dhe procedurën e njëjtë nga autoriteti i ndonjë gjykate tjetër të Kosovës*. Mbulimi i pjesshëm është i lejuar vetëm për atë të referuar nga DHPGJS para 1 janarit 2012 me vendim substancial të nxjerrë nga gjykata e rregullt përkatëse prej kësaj date – Neni 4, paragrafi 4, fjalia e dytë, pika (ii) e LDHPGJS. Përjashtimi nuk është me rëndësi në këtë lëndë që më herët kurrë nuk është referuar nga DHPGJS në Gjykatën Komunale në LIPJAN. Prandaj, nëse Gjykata e Apelit e shqyrton dhe vendos ankesën e MBT kundër aktvendimit C.nr.122/2007 të Gjykatës Komunale në LIPJAN, të datës 25 prill 2012, kjo do të paraqiste *de facto* ushtrimin e juridiksionit sipas Nenit 4, paragrafi 1, nënparagrafi 11 dhe paragrafi 6 i LDHPGJS, jo bazuar në përjashtimin nsipas Nenit 4, paragrafi 4 i LDHPGJS dhe i sanksionuar nga Neni 4, paragrafi 5, fjalia e dytë, pika (i) e LDHPGJS me shfuqizimin e vendimit të saj dhe mundësinë për anulimin e saj nga DHPGJS, jo e ndaluar me kohë. Për t'iu shmangur këtyre pasojave ligjore negative dhe të pajtohet me ndalesën e Nenit 4, paragrafi 5, fjalia e parë e LDHPGJS, Gjykata e Apelit duhet të ndërprej menjëherë procedurën e shkallës së saj të dytë – Neni 4, paragrafi 5, fjalia e dytë, pika

(ii) e LDHPGJS dhe të bart ankesën në AC.nr.3905/2012 në DHPGJS – Neni 4, paragrafi 5, fjalia e dytë, pika (iii) e LDHPGJS.

20. Përbërja dhe organizimi i DHPGJS e udhëhequr nga Kapitulli II i LDHSGJS tani përfshin pesë kolegje të specializuara dhe një kolegji të instancës ankimore, e vërtetuar nga Neni 3, paragrafi 8, fjalia e parë e LDHSGJS. *Kolegjet e specializuara të përbërë sipas Nenit 3, paragrafi 10 i LDHSGJS janë caktuar me juridiksion primar brenda DHPGJS në fushat të cilat qartë janë të paraqitura në Nenin 3, paragrafi 9, nën paragrafët 1–5 të LDHSGJS. Lëndët mbi të cilat asnjë kolegji i specializuar i DHPGJS nuk ka një juridiksion të tillë primar apo për të cilën një kolegji i specializuar akoma nuk është themeluar në kohën kur padia apo ankesa është parashtruar, sipas Nenit 12, paragrafi 2 i Aneksit të LDHPGJS, duhet të merret nga një kolegji i specializuar që të përcaktohet nga rregullat shtesë për t’u aprovuar në pajtim me Nenin 10, paragrafi 1, nën paragrafi 3 i Aneksit. Sa i përket kolegjit të ankesave bazuar në Nenin 3, paragrafi 14, Neni 10, paragrafi 6 i LDHPGJS dhe Nenit 58, paragrafi 1 i Aneksit të LGJSK, ai e ka juridiksionin ankimor ekskluziv dhe të formës së prerë mbi ankesat kundër vendimeve apo aktgjykimeve të nxjerra nga gjyqtari i vetëm, një nën kolegji apo një kolegji i specializuar i DHPGJS apo çdo gjykatë në lidhje me kërkesën, lëndën, procedurën apo lëndën më herët të referuar në të nga DHPGJS sipas Nenit 4, paragrafi 4 i LDHPGJS. Përveç këtyre ankesave qartë të përfshira nga Neni 3, paragrafi 14, Neni 10, paragrafi 6 i LDHPGJS dhe Nenit 58, paragrafi 1 i Aneksit të LGJSK në juridiksion të shkallës së dytë të kolegjit ankimor të DHPGJS, Neni 3, paragrafi 8, fjalia e dytë e LDHPGJS e vazhdon fushëveprimin e saj te gjithë të tjerët brenda kompetencës së DHPGJS, pa i numëruar ato. Prandaj, për shkak të këtij diferencimi strukturor dhe funksional, DHPGJS përmes kolegjeve të saja përkatëse ka mundur të veproj si gjykatë e shkallës së parë në disa raste, dhe si gjykatë e shkallës së dytë në rastet e tjera. Ndarja e saktë interne e kompetencave ankimore primare në mesin e kolegjeve, të kolegjeve dhe gjyqtarëve të vetëm të DHPGJS në mënyrë ekstere nuk është me rëndësi pasi që ato të gjitha iu janë besuar DHPGJS dhe janë rrethuar nga juridiksioni i saj ekskluziv.*

21. Sipas Nenit 1, paragrafi 3 i LDHPGJS, Dhoma e Posaçme është pjesë e Gjykatës Supreme të Kosovës, siç është paraparë nga Neni 21, paragrafi 2 i Ligjit Nr. 03/L-199 mbi Gjykatat. Prandaj, në bazë të hierarkisë gjyqësore nuk është e lejueshme për Gjykatën e Apelit për të vendosur në shkallë të dytë ekzistimin apo mos ekzistimin e juridiksionit të shkallës së parë të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme mbi padinë e parashtruar nga MB kundër NSH “KT”-LIPJAN për anulim të vendimit për shfrytëzim të banesës. Një vendim i tillë i Gjykatës së Apelit në mënyrë direkte do të kundërshtojë Nenin 4, paragrafi 6, fjalia e dytë e LDHPGJS që e ndalon çdo gjykatë tjetër përveç DHPGJS për të vërtetuar nëse çështjet specifike bien apo jo nën juridiksionin ekskluziv të DHPGJS sipas Nenit 4, paragrafi 1 i LDHPGJS. Përveç kësaj, pasi që Gjykata Komunale në LIPJAN, pas 1 janarit 2013 Gjykata Themelore në PRISHTINË, Dega në LIPJAN dhe DHPGJS janë të niveleve të ndryshme, Gjykata e Apelit në pajtim me Nenin 25 të LPK dhe Nenit 18, paragrafi 3, nën paragrafi 3 i

Ligjit Nr. 03/L-199 mbi Gjykatat nuk është i autorizuar të zgjidh ndonjë konflikt potencial të juridiksionit ndërmjet atyre. Një mungesë e një fuqie të tillë e përjashton më tutje mundësinë e Gjykatës së Apelit në shkallë të dytë për të vendosur kompetencën mbi padinë në lëndën C.nr.122/2007 të Gjykatës Themelore në PRISHTINË, Dega në LIPJAN apo DHPGJS. Neni 24, paragrafi 2 i LPK aplikohet në këtë çështje procedurale si jo e adresuar nga LDHPGJS pas rregullës subsidiare të Nenit 14, paragrafi 4 i LDHPGJS.

Ligji Nr. 03/L-006 mbi Procedurën Kontestimore. Ligji Nr 03/L-199 mbi Gjykatat

22. Juridiksioni i Gjykatës së Apelit në këtë lëndë nuk ka mundur të bazohet në LPK. Në pajtim me Nenin 176, paragrafi 3 në lidhje me Nenin 208 të LPK ankesa kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë vendoset nga gjykata e shkallës së dytë. Në mënyrë analogjike, të gjitha normat e Kapitullit XIII të LPK që rregullon procedurën e ankimit kundër vendimeve të shkallës së parë i referohet në mënyrë të përgjithshme gjykatës së shkallës së dytë, pa emëruar atë në mënyrë direkte apo përndryshe duke e individualizuar atë në mënyrë jo direkte. Në bazë të këtij formulimi abstrakt, procedura ankimore kundër aktgjykimeve të shkallës së parë dhe aktvendimeve të udhëhequra nga Kapitulli XIII të LPK duhet të kryhen dhe vendosen nga gjykata e shkallës së dytë që është paraparë me ligj. Pasi që Gjykata e Apelit nuk është përmendur fare, nuk ka mundur të konsiderohet qartë e autorizuar me LPK me kompetencë ankimore duke konkurruar me ato analoge të DHPGJS nën LDHPGJS. Kjo e dyta gjithmonë do të mbizotëroj për shkak të ekskluzivitetit të garantuar në mënyrë normative nën Nenin 4 të LDHPGJS, dhe prioritetin e LDHPGJS mbi dispozitat kontradiktore të rregullores, ligjit apo legjislacionit sekondor sipas Nenit të saj 14, paragrafi 2. Këtu, siç është paraparë nga Neni 19, paragrafi 1 *in fine* të Ligjit Nr 03/L-1999 mbi Gjykatat, kompetenca e shkallës së dytë të Gjykatës së Apelit sipas Nenit 18, paragrafi 1.1 i Ligjit Nr.03/L-1999 mbi Gjykatat në lidhje me Nenin 176, paragrafi 3 dhe Neni 208 i LPK duke qenë i përgjithshëm është deroguar *ex lege* nga juridiksioni ankimor i DHPGJS sipas Nenit 4 të LDHPGJS në lidhje me Nenin 176, paragrafi 3 dhe Neni 208 i LPK.

23. E drejta e Gjykatës së Apelit në këtë lëndë nuk ka mundur të nxirret nga *mjeti juridik* i caktuar nga aktvendimi i kundërshtuar C.nr.122/2007 i Gjykatës Komunale në LIPJAN, të datës 25 prill 2012 si një ankesë të paraqitet brenda 15 ditëve nga dorëzimi i saj në Gjykatën e Qarkut në PRISHTINË. Ky udhëzim i gjykatës së shkallës së parë tek palët në të drejtat e tyre për të paraqitur ankesë të përfshirë në aktvendim si parakusht i përmbajtjes së tij në pajtim me Nenin 160, paragrafi 1 *in fine* në lidhje me Nenin 170 të LPK që nuk e ndryshon juridiksionin ankimor mbi këtë mjet juridik të rregullt si në mënyrë imperative e paraparë nga Ligji i Aplikueshëm. Kjo këshillë juridike e dhenë palëve nuk është mandatorë për Gjykatën e Apelit që e ka detyrën për të shqyrtuar *ex officio* kompetencën e saj të shkallës së dytë apo mos kompetencën në këtë lëndë sipas Nenit 17, paragrafi 1 në lidhje me Nenin 208 LPK.

24. Ankesa e MB kundër aktvendimit C.nr.122/07 të Gjykatës Komonale në LIPJAN, e datës 25 prill 2012 i është adresuar Gjykatës së Qarkut në PRISHTINË. Sidoqoftë, duke qenë veprim procedural i palës, kjo ankesë nuk ka mundur të heq juridiksionin statutor në këtë lëndë siç është paraparë nga LDHPGJS, dhe në fakt nuk e modifikon atë. Sipas Nenit 195, paragrafi 3 i LPK, Gjykata e Apelit megjithatë *de facto* e marrë nga ankesa nuk është e detyruar të vendos, siç është propozuar në atë, dhe ka në tërësi të drejtë të shqyrtoj atë *de jure* kompetencën e saj mbi këtë mjet juridik të rregullt.

Ligji Nr. 04/L-111 duke ndryshuar dhe plotësuar Ligjin Nr. 03/L-087 mbi Ndërmarrjet me Pronësi Publike

25. Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 04/L-111 duke ndryshuar dhe plotësuar Ligjin Nr. 03/L-087 mbi Ndërmarrjet me Pronësi Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr 13/2012) (tash e tutje “LNPP”) më datën 15 qershor 2012, statusi ligjor i NSH “KT” - LIPJAN ishte ndryshuar nga *ndërmarrja me pronësi shoqërore nën administrimin e AKP-së në atë ndërmarrje me pronësi publike*, përfshirë në Listën 2 të Nenit 3, paragrafi 2 i LNPP si Stacioni i Autobusëve në LIPJAN, 100 % pronësi e Komunës së LIPJANIT. Me letrën nr 118 të AKP-së, të datës 4 shkurt 2013 ishte verifikuar ajo që ndërmarrja ishte dorëzuar nga AKP në Komunën e LIPJANIT më 30 korrik 2012. Ky ndryshim është bërë i plotëfuqishëm në procedurën e shkallës së dytë pasi që ishte marrë aktvendimi i kundërshtuar. Pyetja nëse ajo ndikon apo jo në juridiksionin primar të DHPGJS për të vendosur padinë në C.nr.122/2007 të MB kundër “KT”-LIPJAN pas transformimit nga NPSH në ndërmarrje me pronësi publike lokale bazuar në administrimin e *kaluar* të AKP-së ka mundur vetëm të vendoset nga DHPGJS sipas Nenit 4, paragrafi 6, fjalia e dytë e LDHPGJS. Juridiksioni i saj ankimor në këtë çështje nuk ka mundur të shqyrtohet në të ndryshe nga statusi aktual i të paditurit si ndërmarrje me pronësi publike lokale – pas listës së qartë të palëve në procedurë të DHPGJS nën Nenin 5, paragrafi 1, nën paragrafët 1 – 5 dhe Neni 5, paragrafi 2, nën paragrafët – 4 të LDHPGJS, neni i zbrazët 5, paragrafi 1, nën paragrafi 6 dhe Neni 5, paragrafi 2, nën paragrafi 5 i LDHPGJS pastaj të lejoj pjesëmarrjen e *ndonjë personi* që DHPGJS e sheh si të duhur për të pranuar si palë për të siguruar gjykimin e plotë dhe të tërësishëm të lëndës.

Rregullorja e UNMIK-ut Nr 1999/23 mbi Themelimin e Drejtoratit për Çështje Pronësore Banesore dhe Komisionin për Kërkesa Pronësore Banesore

26. Sipas ankuesit kompetenca e DHPGJS në këtë lëndë është përjashtuar pasi që “me vendim e plotëfuqishëm të Drejtoratit për Çështje Pronësore dhe Banesore iu është urdhëruar palëve të vazhdojnë procedurën në gjykatë vendore.” Argumenti i kërkuar do të adresohet nga kolegji në masë që *juridiksioni thelbësor i shkallës së parë* për të vendosur lëndën më tutje paracakton *juridiksionin funksional të shkallës së dytë* për të vendosur ankesat kundër vendimeve të shkallës së parë.

27. Më datën 15 nëntor 1999, Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 1999/23 mbi Themelimin e Drejtoratit për Çështje Pronësore dhe Banesore (HPD) dhe Komisioni për Kërkesa Pronësore Banesore (HPCC) ka hyrë në fuqi. Neni i saj 1.2 parasheh që si përjashtim i juridiksionit të gjykatave vendore, HPD do të pranoj, regjistroj dhe referoj në HPCC për zgjidhje të kërkesave të paraqitura në dispozitë, *inter alia*: a) kërkesat e personave fizik e të cilëve pronësia, posedimi apo e drejta e banimit në pronë të paluajtshme banesore është revokuar pas 23 marsit 1989 në bazë të legjislacionit diskriminues në kërkesë të saj apo qëllim; c) kërkesat nga personat fizik të cilët kishin qenë pronarë, posedues apo bartës të së drejtave të banimit në pronë të patundshme banesore para 24 marsit 1999, nuk e gëzon posedimin e saj, ku prona nuk është bartur në mënyrë vullnetare.

28. E dëshmuar nga dokumentet përkatëse të HPD/HPCC të paraqitura në lëndë, më 23 maj 2003 MB ka parashtruar kërkesë (DS008169) sipas Nenit 1.2 (a) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23 në HPD/HPCC me pretendimet që nga Vendimi me № 012-345 të Këshillit të Punëtorëve dhe Vendimit № 012-349 të Drejtorit të NP "KT", të datës 29 maj 1990 si punonjës i kësaj ndërmarrje atij iu ishte ndarë banesa në Lipjan, Rr. "Vuk Karadzic", P+4, L-2, nr.5/17, dhe e nënshkruar për atë një kontratë mbi shfrytëzimin № 173 më 30 maj 1990 me NPB - Lipjan. Në qershor 1991 masat e dhunshme ishin vënë në NSH "KT" dhe me Vendim të Organit të Përkohshëm të kësaj ndërmarrje, të datës 3 gusht 1991 MB ishte shkarkuar me punonjësit e tjerë të përkatësisë shqiptare. Në vitin 1994 ai ishte dëbuar me dhunë nga policia. Kërkesa e HPD/HPCC ishte për zgjidhje të së drejtës së pronës së tij mbi banesën.

29. Më 22 mars 2002, DZ ka parashtruar kërkesë (DS305615) nën Nenin 1.2 1.2 (c) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23 në HPD/HPCC duke vërtetuar që Vendimi № 012-345 i Këshillit të Punëtorëve të NP "KT", të datës 29 maj 1990 për ndarje të banesës në Lipjan, Rr. "Vuk Karadzic", P+4, L-2, nr.5/1 MBT ishte kundërshtuar nga FH dhe ZD, punëtorë të kësaj ndërmarrje, dhe në fund ishte anuluar me Vendim A.nr.298/91 të Gjykatës së Punës së Bashkuar të Kosovës, të datës 31 maj 1991 për shkeljet e gjetura të Rregullave mbi Ndarjen e banesve të ndërmarrjes në arritjen e pikëve të kandidatëve. Pastaj banesa ishte shpallur përsëri dhe ishte ndarë sërish në një procedurë të re DZ me Vendimin № 554-01-012 të Këshillit të Punëtorëve të NP "KT", të datës 11 mars 1992. Më vonë ai nënshkroi me NPB – Lipjan kontratën mbi shfrytëzimin № 132 më 23 mars 1993 dhe bleu banesën me kontratë Nr 121/012 me NP "KT" më 6 prill 1993, të vërtetuar nën Vr.nr.578/93 nga Gjykata Komunale në LIPJAN më 27 korrik 1993. Mbrojtja ligjore e kërkuar nga DZ ishte riposedimi i banesës.

30. Procedura e HPD/HPCC në kërkesat më lartë, të dyja të paraqitura brenda afatit ligjor sipas Nenit 3.2, fjalia e dytë e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60 – 1 korrik 2003, sikurse duke garuar për një dhe banesën e njëjtë, dhe duke ngritur çështje dëshmuese dhe ligjore të zakonshme, janë bashkuar bazuar në Nenin 19.5 (a) të

Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23. Kështu të lidhura, DS008169 & DS305615 në fund të dyja janë zgjidhur me Vendimin Nr HPCC/REC/82/2006, të datës 7 dhjetor 2006, të marrë nga HPCC në procedurë të shqyrtimit të shkallës së saj të dytë Neni 14.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60. Në pikën 1 të dispozitivit HPCC ka urdhëruar: *Kërkesa A DS008169* e MBT të hidhet poshtë; b) përcaktimi i mbrojtjes ligjore, nëse ka, në dispozicion të këtij paditësi A sipas ligjit të aplikueshëm për mënyrë gjoja të parregullt në të cilën banesa iu ishte ndarë dhe fituar nga paditësi C të referohet në *gjykatën kompetente vendore*; c) bartjet e pronës ishin ndaluar deri në vendim të *gjykatës kompetente vendore* përveç bazuar në vendosjen miqësore të kontestit; d) urdhri i ngrirjes do të kalonte derisa paditësi A brenda 60 ditëve të paraqes në *gjykatën kompetente vendore* një njoftim të qëllimit të tij për të vazhduar procedurën në *gjykatën kompetente vendore* (i); dhe mund të ndryshoj apo të lirohet nga *gjykata kompetente vendore* nëse intereset e drejtësisë kërkojnë kështu në pajtim me ligjin e aplikueshëm (ii)". Në pikën 2 të dispozitivit Vendimi Nr. HPCC/REC/82/2006, i datës 7 dhjetor 2006 në lidhje me DS305615 kërkesa e HPCC urdhëroi: a) DZ të i jepet posedimi i banesës; b) çdo person që e ka uzurpuar të liroj atë brenda 30 ditëve; c) uzurpuesi të dëbohet me mos përmbushjen brenda kohës së treguar.

31. Në arsyetim të vendimit Nr. HPCC/REC/82/2006, të datës 7 dhjetor 2006 (paragrafët 3, 4, 5 dhe 7) HPCC ka arsyetuar hedhjen poshtë të DS008169 me dështim të MB si paditës i kategorisë A për të dëshmuar vlefshmërinë e të drejtës pronësore mbi banesën nën Nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23 dhe Nenit 2.2 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60 lexo definicionin e saj ligjor në Nenin 1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60 si vendim i saj mbi ndarjen № 012-345 të lëshuar nga Këshilli i Punëtorëve të NP "KT" më 29 maj 1990 ishte ankimuar, dhe anuluar me Vendimin A.nr.298/1991 të Gjykatës së Punës së Bashkuar të Kosovës, të datës 31 maj 1991. Sa i përket kërkesës së lidhur C DS305615 të DZ, HPCC ka arsyetuar aprovimin e saj në paragrafin 14 të arsyetimit me *prima facie* të treguar në të drejtat pronësore mbi banesën, humbjen e posedimit të saj në rrethanat që ndërlidhen me fushatën ajrore të NATO-s, mungesën heqjes dorë vullnetare të pronësisë së saj, në pajtim me kriteret e Nenit 1.2 (c) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23 dhe Nenit 2.6 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60. HPCC ka vendosur të rregulloj këtë rezultat me referim të pretendimeve për diskriminim në *gjykatën kompetente vendore* në bazë të shkarkimit të MB i atribuuar në masa të përkohshme në NP "KT" në vitin 1991 që e ka penguar atë të aplikoj në procedurë të re të shpallur për ri ndarje të banesës. Vendimi i HPCC Nr. HPCC/REC/82/2006, i datës 7 dhjetor 2006 ishte nënshkruar nga Kryesuesi në pajtim me Nenin 22.9, fjalia e parë e Rregullores së UNMIK-ut Nr 1999/23. *Plotëfuqishmëria* e tij prej datës së lëshimit ishte qartë e verifikuar në faqen e tij të fundit duke qenë i referuar dhe cituar në dispozitën e Nenit 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23.

32. Përkundër pikëpamjes së ankuesit, Vendimi i HPCC Nr. HPCC/REC/82/2006, i datës 7 dhjetor 2006 nuk ka para caktuar juridiksionin e kësaj lëndë në shkallë të parë apo/të dytë. Në vend të parë, këtu nuk ka *ex officio* referim nga HPCC tek ndonjë

gjykatë vendore sipas nenit 2.5, fjalia e dytë e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23 të ndonjë pjesë specifike të kërkesave DS008169&DS305615 si çështje jo të ngritura sipas Nenit 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60 të çështjeve të cilat ngriten në lidhje me këto kërkesa të cilat nuk bien brenda juridiksionit të HPCC-së. Duke vepruar brenda delegimit të Nenit 22.7 (g) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60 të bëj ndonjë vendim tjetër apo urdhër i nevojshëm të i jap fuqi rregullore, nga pika I.1 (b) e Vendimit Nr HPCC/REC/82/2006, të datës 7 dhjetor 2006 HPCC vetëm udhëzoi paditësin A për të përcaktuar mbrojtjen ligjor sipas ligjit të aplikueshëm për gjoja ndarje të parregullt dhe fitim të banesës nga Paditësi C në procedurë gjyqësore para gjykatës kompetente vendore. Përsëri sipas Nenit 22.7 (g) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60 nga pika I.1 (c) e Vendimit Nr. HPCC/REC/82/2006, të datës 7 dhjetor 2006 të ndaluar ish-in të gjitha bartjet e pronës përveç me marrëveshje miqësore, deri në vendim të gjykatës, derisa të kaloj ngrirja e urdhrit për mos iniciim të procedurës gjyqësore brenda 60 ditëve. Përveç kësaj, DS008169 & DS305615 ish-in zgjidhur nga Vendimi Nr. HPCC/REC/82/2006, të datës 7 dhjetor 2006 referim pa *ex officio* nga HPCC tek çdo gjykatë e Kosovës kërkesat në tërësi sipas Nenit 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60, pjesët e tyre specifike sipas Nenit 2.5, fjalia e dytë e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23, apo çështjet e ngritura në lidhje me këto kërkesa sipas Nenit 22.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60. Pa referim të drejtëpërdrejt nga HPCC tek ndonjë gjykatë konkrete Kosovare në ndonjërin nga alternativat e mësipërme, të urdhëruar nga Vendimi Nr. HPCC/REC/82/2006, i datës 7 dhjetor 2006, kjo e dyta bile nuk ka mundur të jap efektin e saj obligues ligjor teorikisht sipas Nenit 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut Nr.1999/23 sipas juridiksionit të mbrojtjen ligjore të anti diskriminimit të lënë për t'u kërkuar apo jo nga kategoria e paraqitësit të kërkesës A. Prandaj, kompetenca mbi procedurën gjyqësore për përcaktimin e saj pas mbylljes së lëndës së HPCC-së duhet të definohet në bazë normative vetëm. Në vend të dytë, e njëjta i referohet nga teksti i HPCC Vendimit Nr. HPCC/REC/82/2006. Të gjithë urdhrat nga pika e saj I.1 (b) – (d) sa i përket mbrojtjes ligjore të anti diskriminimit i referohet në përgjithësi “gjykatës kompetente vendore”, pa e konkretizuar atë. Kështu, HPCC e ka mbajtur çështjen për diskriminim në fitimin e të drejtave pronësore mbi banesën dhe/apo shpërblimin e kompensimit për dëmet që kanë mundur të shkaktohen tek MB pas 23 marsit 1989 në gjykatën vendore duke pasur juridiksion nën ligjin e aplikueshëm. Gjykata Komunale në LIPJAN nuk është në mënyrë të drejtëpërdrejt e paraparë në HPCC Vendimin Nr. HPCC/REC/82/2006, e as nuk është e specifikuar në mënyrë indirekte. Në vend të mbrojtjes ligjore anti diskriminuese që iu ishte lënë gjykatës vendore kompetente për të zgjidhur kontestin, siç është paraparë me ligj. Referimi përkatës në Vendimin Nr. HPCC/REC/82/2006 duke qenë në mënyrë abstrakte të formuluar duhet të interpretohet si duke mbuluar ligjin e plotëfuqishëm në kohën e lëshimit të tij, të gjitha dokumentet në të dhe nëse shfuqizohet apo zëvendësohet – çdo ligj i ri, i përgjithshëm apo i veçant, që bëhet i formës së prerë gjatë procedurës gjyqësore i udhëhequr nga Paditësi A. Përveç kësaj, si Vendimi Nr. HPCC/REC/82/2006, të datës 7 dhjetor 2006 e delegon çështjen në

“gjykatën kompetente vendore” të definohet nga ligji i aplikueshëm, nuk e vazhdon apo përndryshe modifikon juridiksionin përkatës normativ por në aspektin teknik i referohet atij. Prandaj, delegimi mund të aplikohet në çdo gjykatë të Kosovës, përfshirë DHPGJS, që duke pasur gjyqtarë ndërkombëtarë në përbërje të saj në pajtim me Nenin 3, paragrafi 1 i LDHPGJS, është pjesë e Gjykatës Supreme të Kosovës në pajtim me Nenin 1, paragrafi 3 i LDHPGJS, dhe sistemit gjyqësor të Kosovës në pajtim me Nenin 8, paragrafi 1 dhe Neni 21, paragrafi 2 i Ligjit Nr 03/L-199 mbi Gjykatat. Në vend të tretë, bazuar në HPCC Vendimin Nr HPCC/REC/82/2006, të datës 7 dhjetor 2006 asnjë lëndë nuk është dërguar nga HPCC në Gjykatën Komunale në LIPJAN, e as MBT nuk iu kishte dhënë këshillë ligjore nga HPCC për të filluar procedurën në çështjen e diskriminimit para Gjykatës Komunale në LIPJAN. Në vazhdim të procedurës së ndërprerë në C.nr.194/1993 (C.nr.122/07) pas përfundimit të lëndës së HPCC nuk ka përfshirje të DHPGJS. Prandaj, ky nuk është referim i mëhershëm i padisë, çështjes, procedurës apo lëndës nga DHPGJS në Gjykatën Komunale në LIPJAN sipas Nenit 4, paragrafi 4, fjalia e parë e LDHPGJS që automatikisht e përjashton çdo juridiksion të gjykatave të rregullta në shkallë të palë dhe ankimore në përjashtim të Nenit 4, paragrafi 4, fjalia e dytë, nën pika (ii) e LDHPGJS.

IV. PËRFUNDIM

33. Bazuar në shqyrtimet e mësipërme, trupi gjykues arrin në përfundim që DHPGJS sipas Nenit 4, paragrafi 1, nën paragrafi 11 dhe Neni 4, paragrafi 6, fjalia e dytë e DHPGJS ka kompetencë ekskluzive për të vendosur ankesën e MBT kundër aktvendimit C.nr.122/2007 të Gjykatës Komunale në LIPJAN, të datës 25 prill 2012 me qëllim të përcaktimit nëse padia në shkallë të parë bie apo jo brenda fushëveprimit të kompetencës së saj ekskluzive sipas Nenit 4, paragrafi 1 i LDHPGJS. Pasi që vetëm DHPGJS ka të drejtë të shqyrtoj ekzistimin apo jo ekzistimin e juridiksionit të saj në shkallë të parë dhe të dytë, fuqia statutore për shkak të ekskluzivitetit të saj sipas Nenit 14, paragrafi 2 LDHPGJS i shfuqizon kompetencat e Gjykatës së Apelit sipas Nenit 18 të Ligjit Nr. 03/L-199 mbi Gjykatat për të vendosur këtë ndër kompetencë në shkallë të dytë. Ky autoritet duke qenë ligjërisht i koncentruar në DHPGJS është *de jure* i përjashtuar me Nenin 4, paragrafi 5, fjalia e parë e LDHPGJS për të gjitha gjykatat tjera, ndërsa ushtrimi i saj *de facto* nga ata është i ndaluar me Nenin 4, paragrafi 5, fjalia e parë e LDHPGJS. Për këto arsye, Gjykata e Apelit e deklaroi vetën si jo kompetente për të vendosur ankesën në lënda AC.nr.3905/12 sipas Nenit 18, paragrafi 1 i LPK dhe e referon atë në DHPGJS si gjykatë kompetente e shkallës së dytë sipas Nenit 23, paragrafi 1 i LPK.

Në bazë të arsyetimit të sipërpërmendur vendoset sikurse në dispozitiv.

MJETI JURIDIK: Asnjë ankesë nuk është e lejuar kundër këtij aktvendimit në pajtim me Nenin 206, paragrafi 1 *in fine* në lidhje me Nenin 208 dhe Nenit 176, paragrafi 1, fjalia e parë e LPK.

GJYKATA E APELIT - PRISHTINË
AC.nr.3905/2012 më 12.03.2013

KRYETARJA E KOLEGJIT ROSITZA BUZOVA

Përgatitur në Anglishtë si Gjuhë zyrtare në pajtim me Nenin 17 të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetenca, Përzgjedhjen e Lëndës, Caktimin e Lëndës të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë

PËRKTHYER NGA ANGLISHTJA NË SHQIP NGA:
DAUT LATIFAJ, PËRKTHYESE NË EULEX

SHENIM MBI KESHILLIMIN DHE VOTIMIN

GJYKATA E APELIT në shkallë të dytë përmes kolegjit të përbërë nga Gjyqtarja Civile e EULEX-it ROSITZA BUZOVA, si Kryetare e Kolegjit, Gjyqtari kosovar MUHARREM SHALA dhe Gjyqtari kosovar NENAD LAZIĆ, si anëtarë të kolegjit, në seancë të mbyllur më 12 mars 2013 këshilluan dhe votuan në mënyrë unanime sikurse në dispozitiv.

Shënimi aktual i shtohet aktvendimit AC.nr.3905/12 të Gjykatës së Apelit, të datës 12 mars 2013 sipas Nenit 140, paragrafi 1, fjalia e dytë e LPK.

GJYKATA E APELIT - PRISHTINË
AC.nr.3905/2012 Më 12.03.2013

KRYETARJA E KOLEGJIT TË EULEX-IT
ROSITZA BUZOVA

GJYQTARI MUHARREM SHALA
ANËTAR I KOLEGJIT

GJYQTARI NENAD LAZIĆ
ANËTAR I KOLEGJIT

ANDRES MORENO
ZYRTAR LIGJOR I EULEX-IT

DAUT LATIFAJ
INTERPRET/PERKTHYES I EULEX-IT (ANGLISHT/SHQIP)

JELENA JANJIĆ
INTERPRETE/PËRKTHYESE (ANGLISHT/SERBISHT)

Përgatitur në Anglishte si Gjuhë zyrtare në pajtim me Nenin 17 të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Komptencat, Përgjedhjen e Lëndëve dhe Çaktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë dhe nënshkruar nga Gjyqtarët kosovarë pas përkthimit nga interpretët/përkthyesit e referuar më lart.

PËRKTHYER NGA ANGLISHTJA NË SHQIP NGA:
DAUT LATIFAJ, PËRKTHYESE NË EULEX